



SEKRETI I SUNDIMIT TË BOTËS

Procesverbalet e pleqësisë sioniste



Përktheu: Fatos Aliu



SEKRETI I SUNDIMIT TË BOTËS
Procesverbalet e pleqësisë sioniste

Përktheu: Fatos Aliu

Përgatiti për botim
L & M
GËZHILLI
Arti grafik
Kleida Maluka

(C) i këtij botimi Argeta – LMG, Tiranë 2002

VËSHTRIM MBI LIBRIN: «SEKRETI I SUNDIMIT TË BOTËS»

Duke shfletuar kalimthi këtë libër, të cilin mund ta quajmë Manual për sundimin e botës, fillimisht kisha dyshimin se mos mund të ishte një nga qindra librat e zhanrit mistik të fantazisë, edhe pse nuk isha i panjohtuar me lëndën apo plagjiaturën e tij të konvertuar të programit nazist të veprës “*Mein Kampf*” të Adolf Hitlerit, të dorës së zgjatur apo të mashës së komplotit antinjerëzor, të Luftës së Dytë Botërore, me pasojat katastrofale për njerëzimin dhe vet popullin gjerman, i cili në “bisedimet” me Rauschningun shprehej: “*Në kohën time kam qenë singërisht i tronditur duke lexuar “Procesverbalet e dijetarëve sionistë”...E kam kuptuar menjëherë se duhet ta zbatojmë, natyrisht, në mënyrën tonë (7, fq. 92). Kam mësuar shumë nga këto “Procesverbale”. Në përgjithësi, unë kam mësuar shumë nga armiqtë e mij. Teknikën revolucionare e kam mësuar nga Lenini dhe Trocki dhe marksistët tjerë... I çmendur është ai i cili nuk mëson nga armiqtë e tij. Vetëm i ligu frikohet se tek ato i humb idetë e veta personale...Më së shumti kam mësuar nga jezuitët. Këtë e ka bërë edhe Lenini. Deri sot asgjë në botë nuk ka më madhështore se sa rendi hierarkik i kishës. Shumë nga ky rend kam marrë për partinë time ”. Përkthyesi i këtij libri në kroatisht, Dr. Franjo Letiq, duke arësytuar botimin e tij, thekson: “*A duhet të heqim dorë nga Nobeli, sepse botës ia ka zbuluar dinamitin me të cilin kjo botë mund të shkatërrohet (a nuk i bëhet nderimi më i madh çdo shkencëtari apo shkrimtari marrja e shpërblimit Nobel?), ose nga zbuluesi i energjisë atomike, sepse ajo mund të keqpërdoret?” Ky libër, i botuar në fillim të shekullit XX, ka bërë jehonë të madhe, duke revoltuar e nxitur qarqet hebrenje për ta ndaluar apo larguar nga publiku, që ka ngritur çmimin e tij të shitjes në kuota milionëshe.**

Përmbajtja e këtij manuali në formë të procesverbaleve të seancave, nga 1 gjer 27, dëshmon për fillet e hershme të programit monstruz por praktik të dominimit të botës, i cili i ka paraprirë dhe nxitur ngjarjet e mëpastajme që kanë ndodhur, si edhe të atyre që parashihen në të ardhmen, rezultat i skenareve të planifikuar me domethënie dhe zbatim në botë, siç e thonë edhe autorët e këtij programi: “*Në vend të sunduesve mbretëror, do të vendosim vet Demonin, të cilin të gjithë do ta konsiderojnë Qeveri Mbishtetërore. Duart e tij do të shtrihen në të gjitha anët si*

kthetra, ndërsa organizata e saj do të jetë aq fuqiplote sa të sundojë me tërë botën.” (Seanca e dhjetë: “Mbiqeverisja e jonë”).

Po ta trajtojmë këtë libër thjesht si pjellë të një fantazie utopiste, mund biem në grackën e verbësive tona dhe të qëllimeve të tij, ngado që ta ketë burimin. Motoja e misionit të procesverbaleve të këtij programi apo manuali është kuptimplotë: *sundimi i botës me të gjitha format dhe mjetet në dispozicion, pa marrë parasysh viktimat dhe pasojat, ose, shkatërrimi i saj.* Një program i këtillë mund të jetë produkt i mendjeve të destruksionit gjenial, i cili ka gjetur aplikim në skenën politike botërore, sa herë që janë shfaqur krizat, si nxitës apo shkaktar i tyre, duke provokuar reaksionet e njerëzimit në vetëmbrojtje nga forcat e errësirës, të personifikuara me liderë-maniakë të botës, siç është Demoni i kësaj vepre.

Ngjarjet e kohës sonë dëshmojnë se shkaqet e trazirave dhe të zhvillimeve në botë nuk janë rastësi, apo vetëm luftë interesash kombesh e shtetesh, luftë fesh apo ideologjish, por luftë e imperatorive për të sunduar botën, me misione për interesa të programuara, kryesisht shfrytëzuese të vendeve në zhvillim, që kanë sjellë më shumë luftra se paqe, më shumë shkatërrim të natyrës se kultivim të saj. Sa është ky program uigurzi i realizueshëm? Kush qëndron prapa tij? Sa qëndrojnë pohimet e përmbajtjes së tij si program sionist, me të cilin instrumentalizohen hebrenjtë? Cili është synimi i mbjelljes së urrejtjes kundër tyre? Lexuesi mund të konkludojë edhe vetë për qëllimet e krijimit të këtij programi. Hebrenjtë kanë përjetuar vuajtje si edhe populli shqiptar, i cili i ka strehuar e mbrojtur, në kohërat më të vështira të nazizmit: *“Një qind për qind të hebrenjëve në Shqipëri kanë shpëtuar nga Holokausti”* (Harvey Sarnet, *“Rescue in Albania”*). *“Kisha ortodokse serbe, nëpërmes bishopit Velimiroviq, “profetit” serb me influencë më të madhe pas Sveti Savës, ka zbatuar antisemitizmin e vet në shërbim të nazizmit, duke persekutuar dhe zhdukur hebrenjtë në Serbi. Idetë dhe planet për Serbi të Madhe etnikisht homogjene, i kanë rrënjët thellë në politikën e Serbisë, të kodifikuara me memorandumun intern “Naçertanije”, të ish ministrit serb Ilija Garashanit, më 1844”* (*“Serbia’s Secret War”*, Philip J. Cohen). Këto ide tanimë njihen botërisht. Fillet e “Naçertanjes” janë pjesë e programeve sllavomëdha të Rusisë, të cilat kanë marrë rrugë e gjetur zbatim në periudhat e mëpastajme të regjimeve serbe, gjer në ditët e sotme, me një synim kryesor: dalja në detra të ngrohta nëpërmes zhdukjes dhe shpërnguljes së shqiptarëve.

Nuk duhet edhe aq shumë për të zbuluar lojën apo trukun e këtij programi, në grackat e të cilit tanimë kanë rënë liderë të disa shteteve, duke nxjerrë plagjiaturat e tyre, për misionet dhe interesat e tyre megalomane, të cilat kanë përfunduar me pasoja katastrofale për njerëzimin. Liderët e errësirës e tregojnë vetë synimin konspirativ të tyre (të dalë sheshit!), duke e bërë sa sinonim të së keqes, po aq edhe mjet të popujve për t’u mbrojtur nga e keqja, e cila qëndron si hije permanente, si ushtri kobsjellëse e gatshme për të vepruar sa herë që degradon mendja dhe fuqia njerëzore. Ndonëse autorët e këtij manuali - apo të kësaj kryevepre demonike, e kanë projektuar mjaft bindshëm misionin e tyre djallëzor, duke i shfrytëzuar me mjeshtri dobësitë njerëzore e marrëdhëniet e degraduara të jetës shoqërore në botë, ai mund të shërbejë për të kuptuar më mirë prejardhjen e ngjarjeve tragjike të përjetuara gjatë historisë, të cilat mund të përsëriten, nëse njerëzimi nuk nxjerr mësim nga e kaluara.

Në fakt, misioni për sundimin e botës sipas këtij programi, me planet despotike të cilat i përmban, për të vendosur rendin e proklamuar botëror, synon shkatërrimin e saj dhe të njerëzimit. Të gjitha seancat ligjëruese të këtij programi i përshkon ekspozeu gjakftohtë i referuesit, i liderit enigmatik të planeve dhe

metodave të kompletit botëror, të cilat duhet zbatuar nëpërmes mashtrimeve dhe marrjes sistematike të kontrollit dhe të pushtetit, duke i futur qetë dhe hap pas hapi kthetrat e padukshme në çdo pjesë të organizmit të shteteve dhe popujve të botës. Programi zbulon fshehtësitë dhe artin e uzurpimit të pushtetit politik, psikologjinë e depërtimit në masa, metodologjinë praktike të sistemit të rivendosjes së kontrollit ekonomik dhe të rrënimit të qeverive në botë.

Këtu do t'i theksoj vetëm disa nga "margaritarët" e këtij programi, të përmbledhur dendësisht dhe gjërësisht në formë koncentri në këtë manual: "Do të frikoheshim sikur forcat e dukshme të qeverive Goje të lidheshin me forcën e verbër të popullit. Por ne i kemi marrë të gjitha masat kundër një mundësie të këtillë: midis këtyre dy forcave kemi ngritur një MUR të fortë mosbesimi. Kështu, forca e verbër e popullit do të mbetet një mbështetëse e jona, ne do të jemi udhëheqësit e saj, duke e drejtuar në kahje të qëllimit tonë. Për këtë do të kujdesen agjentët tanë, të futur në brendinë e popullit" (Seanca e tretë).

Për të mbjellur farën e përçarjes dhe të konflikteve të brendshme, këta strategë të magjisë moderne i kanë paraparë dhe zbatuar me kohë planet e tyre: "...sistemet rigoroze gojime i kemi zëvendësuar me rregullime idioteske liberale dhe anarkike, duke ndikuar në ligjet zgjedhore, në shtyp, në lirinë individuale, dhe, që është më me rëndësi, në arësim dhe edukim... (Seanca e katërt). Në të gjitha shtetet jasht nesh, duhet të ekzistojnë vetëm masat proletare, disa milionerë të besueshëm, policia, ushtria dhe qeverisja e jonë".

Këta magjistare misionin e tyre e qartësojnë edhe më shumë kur thonë: "Sot më asnjë ministër nuk mund të mbahet në pushtet pa mbështetjen tonë, apo pa përkrahjen tonë formale, të cilën ne e përgatisim prapa perdes." (Seanca e pestë).

"Tanimë në gazetari ekziston solidariteti masonerik, që ka parollën e vet...Mjerimi, zbrazëtia, kryelartësia dhe të metat e tjera janë garancë e dëgjueshmërisë së gazetarit, i cili nxiton pas suksesit duke shkaktuar nënshtrimin e tij ndaj solidaritetit masonerik. Kjo hapësirë mbetet e mbyllur për shumë shpirtëra të mëdhenj, të cilët, si të papërkulshëm ndaj urdhëresave tona, nuk mund të hyjnë në të" (Seanca e trembëdhjetë, "Shtypi dhe masoneria").

"Kur ne të vijmë në pushtet, do ta ndryshojmë në themel sistemin financiar të Gojëve...Mendjelehtësia e pushtetarëve gojimë, korrupsioni i ministrave të tyre, apo mosnjohja e çështjeve financiare, sa i përket punëve shtetërore, ka shkaktuar nënshtrimin e popujve ndaj nesh, duke i detyruar të krijojnë borxhe tek ne, nga të cilat nuk do të mund të lirohen kurrë..." (Seanca e dhjetë).

Fuqitë përparimtare pozitive në botë duhet ta kenë alternativën e këtij programi, gjatë ndërtimit të sistemeve të reja demokratike, në të cilat thirren. Sepse, siç paralajmëron edhe autori amerikan i bestsellerit Ballkan Ghosts, Robert D. Kaplan, në librin e tij The coming Anarchy: "demokracinë të cilën po e inkurajojmë aktualisht në shumë vende të varfëra të botës, është pjesë integrale e transformimeve në kahje të formave të reja të autoritarizmit..."

Ky manual mbi artin e sundimit të botës, para se të paragykohet mbi qëllimet që përmban, duhet marrë e trajtuar si sfidë për njerëzimin, për vetëdijësimin e tij mbi të këqijat të cilat i kanosen natyrës dhe ekzistencës së tij, për domosdonë e krijimit të botkuptimit të ri njerëzor mbi botën, të përmirësimit të virtyteve dhe të raporteve ndërnyerëzore.

Ofendimet që i bëhen, skenaret dhe kompletet të cilat ia përgatisin këta dijetarë-maniakë të errësirës popujve dhe shteteve të botës, para se të mirren si shprehje e ligësisë së tyre shpirtërore, parashtrojnë sfida të reja për dijetarët e botës së shëndoshë, për ta mbrojtur dhe realizuar begatinë e mrekullisë së natyrës e të shpirtit të vërtetë njerëzor. Në kuptim filozofik të vështrimit të tij, nuk

është primare se kush qëndron prapa këtij programi, për të instrumentalizuar këtë apo atë popull, shtet apo qeveri. Sfida gjendet brenda çdo individ, kombi, shteti apo qeverie për të zgjedhur destinacionin e tij. Atje ku EGO-ja pushton UNIN, atje individ apo shoqëria merr fund, arrin kulmin e vetërobërimit, të vetëpushtimit dhe të kapitullimit. Pushtimeve të tjera i hapet dera lirshëm, dhe djalli bëhet zot shtëpie.

Duke kujtuar filozofinë niçeanë mbi njeriun do të shtonim: “njerëzit tek të cilët mbizotëron shpirti, duke qenë më të fortët, lumturinë e gjejnë atje ku të tjerët do ta gjenin shkatërrimin e tyre, tek labirintet e të panjohurës, tek përpjekja e pandalur për të gjurmuar të vërtetën. Kënaqësia e tyre është zotërimi i vetvetës, asketizmi i tyre bëhet natyrë, nevojë, instikt. Detyra e vështirë për ta është privilegj, loja me barrën e cila të tjerët i shtyp, për ta është një çlodhje. Ata janë lloji më i nderuar i njerëzve, më të qetët, më të dashurit. Ata dominojnë jo pse e duan këtë, por sepse nuk janë të zotë të jenë të dytët. Ata janë rojtarët e së drejtës, tutorët e rendit dhe të sigurisë, lufëtarët fisnikë, ruajtësit e ligjit. Për mediokrin është lumturi të jetë mediokër, të shkëlqejë vetëm në një gjë. Për ata dituria është vetëm një drejtim, një instikt.” Mëtej do të shtonim se; njeriu i lig apo përfaqësuesi i errësirës është mistreci xheloz; gjuetar, krijues dhe tregtar i intrigave e i gënjeshtreve, i mësuar të qëllojë ultas pastaj të tërhiqet si hijena, i cili njeh dhe respekton vetëm sistemin e frikës dhe të dhunës, të cilit i nënshtrohet me servilizëm. Ky lloj njeriu i përshtatet misionit djallëzor të dekadencës (të paraparë me këtë manuel) dhe nuk i duron shpirtërat që nuk i gjasojnë, dhe lufton njeriun i cili synon përtërirjen qytetare të origjinës së natyrshme dhe jo degjenerimin e kundërnatyrshëm: qytetërimin e rrejshëm, qytetarin e pashpirt, jetën moçalike të bretkocave të fryera e boshe. Shpirtërat e shitur apo të vdekur gogolianë, i shërbejnë me përkushtim të sëmure të konformistit jokurrizor misionit të autorëve të këtij maneli, për të degraduar e defaktorizuar intelektin dhe shpirtin autokton të vendësit. Njeriu i vërtetë, duke luftuar të keqen, lufton së pari me njeriun e keq brenda llojit të vet. Betejat e humbura nuk e dekurajojnë - përkundrazi; e sfidojnë dhe forcojnë. Ai synon të fitojë luftën dhe nuk dëshprohet nga dështimet në beteja, nga të cilat nxjerr mësim, për të njohur veten dhe të tjerët, për t'i dalluar miqt e vërtetë dhe të rrejshëm. Nga dështimi merr lekcione të merituar për të vazhduar luftën, sepse e di se ndalja sjell dështimin e vërtetë.

Duke u shprehur me fjalorin herë pas herë (anti)biblik të këtij programi, do të gjykonim: mos vallë duke u thirrur në Perëndinë, si “i dërguar” i tij, Djalli spekulon për të sfiduar Njeriun, të krijuar nga Perëndia? Pasiqë Djalli e ka tradhëtuar Perëndinë, si mund të jetë i deleguari i tij?! Apo, shikuar nga këndi tjetër: që të dy, Njeriu dhe Djalli, të krijuar nga Perëndia, kanë misionet e tyre, plotësisht të kundërt njëri me tjetrin. Pse? Për të garuar, sikur Dr. Fausti dhe Mefistofeli?! Bota është krijuar për të sfiduar njeriun e papërsosur për të synuar përsosjen duke jetuar natyrshëm, pasiqë, sipas librave të shenjtë, njeriu në vete i përmban këto mundësi. Për këtë ekziston djalli, përgjuesi dhe gjuetari i gabimeve të njeriut! Gabimi erdhi që në kohën e krijimit të njeriut, Adamit dhe Evës, të cilët, duke i harruar këshillat e Perëndisë, e hëngrën mollën e ndaluar në parajsë, nga epshet e botës materiale, në të cilat i ka shtyer djalli. Fitorja dhe përsosja e njeriut arrihet në punën dhe kujdesin e tij për të mos rënë në grackat e djallit, i cili qëndron pranë njeriut si edhe vet Perëndia. Rruga të cilën e zgjedh njeriu përcakton fatin e tij, të dritës apo errësirës, të fitores apo humbjes, të robërisë apo lirisë. Në këtë kuptim, libri është i qartë dhe këshilldhënës. Nëse është djallëzor, nuk mund të mohohet gjenialiteti destruktiv i programit. Ndoshta është

program i ndërtimit të Rendit të Ri botëror të djallit, apo sfidë për të ndërtuar Rending e Ri botëror të Perëndisë?

Në kuptim të ngjashëm mund t'i vështrojmë edhe ngjarjet e kohës, e në këtë kontekst, edhe fatin e kombit shqiptar. Se ekziston misioni i errësirës dëshmi për këtë është historia e tij, krimet shekullore të zhvilluar ndaj popullit shqiptar. Se kombi ynë akoma gjendet në kthetrat e këtij misioni - "të njëqind duarve të zgjatura të Zotit Vishnu"- apo të "protektorit" tonë të harlisur shumë-kokësh që sillet si rojtar i pakontestueshëm me të drejta absolute pushtetore mbi popullin shqiptar dhe pasurinë e tij, dëshmon edhe pozita e tij aktuale kombëtare e territoriale; i nëpërkëmbur, i copëtuar dhe i kolonizuar. A është kjo rastësi, apo është një mision djallëzor i misionarëve dje dhe sot, për të maskuar të vërtetën, çelsin e së cilës e kanë vjedhur mijëra vjet përpara, për ta mbajtur peng tërë njerëzimin?

Çka duhet bërë për t'u liruar nga kjo ndrydhje shpirtërore të vendosur nga këto ushujza misionarësh moderne? Cili është ilaçi për t'u shëruar nga kjo sëmundje virusale moderne? Kujt i shërbejnë, nëse jo një misioni të ngjashëm sipas këtij manueli?

Këtë mund ta dijnë dhe bëjnë vetëm shpirtërat rebelë dhe jokonformistë, me një Rilindje të Re: "si në mes të detit të tallëzitur, që ngre lart dhe lëshon pastaj me vërtik poshtë dallgët si male, qëndron i palëkundur njeriu, që i është besuar barkës së dobët, ashtu në mes të botës me mundime mbijeton, njeriu i vetmuar, i kapur plot besim pas principum individuationus" (Shopenhauer).

Mos janë edhe shqiptarët shkaku dhe qëllimi i krijimit të këtij plan-programi, meqenëse mbijetesa dhe prejardhja e tyre pellazgo-iliro-etruske, hedh në dritë të vërtetën që nuk guxon të zbulohet, sepse e demaskon misionin djallëzor të sundimit të botës? Përpiluesi i hieroglifëve egjiptase - çelësave deshifrues të Biblës e Kuranit - profeti Thot, fliste shqip, thotë Giuseppe Catapano në veprën e tij "Thot - parlava albanese". Mbishkrimet më të vjetra në tokë flasin shqip - gjuhë nga e cila lindën gjuhët tjera të popujve të botës. Pse nuk lejohet, apo pse u ndalua botimi i këtij libri? Si dhe pse u zbuluan atëherë vetëm programet kriminale e monstruze të sundimit; sionist, nazist, sllavo-ortodoks, serbomadh e grekomadh etj., që të gjitha duke u thirrur në hyjnoren?! Në cilën hyjnore? Nga filozofët e kohës së vjetër mësojmë për popujt e Hënës, të cilët erdhën në fuqi, pas agresioneve të njëpasnjëshme të fiseve të egra primitive, duke lakmuar dhe uzurpuar begatinë e popujve të Diellit, për të filluar me jetën e shfrenuar apo të imitacionit të jetës apolloniano-dionisiane, që nga Vitet e Arta të Athinës, të cilat në fakt, siç thoshte filozofi antik Thukidi, ishin edhe vitet e përfundimit të Epokës së Artë, vitet kur Herakliti paralajmëronte: "mos ju mbaroftë pasuria o burra të Efesit, që t'ju turpërojnë poshtërsitë tuaja".

Burrështetasi athinas Soloni, me rastin e udhëtimit të tij në Egjiptin e lashtë dhe pas konsultimeve me dijetarë egjiptas mbi artin e udhëheqjes së shtetit, merr këtë përgjigje: "*Solon, Solon, ju grekët e sotëm, nuk jeni ata të vjetrit, ju nuk e dini se para jush në këto pellgje ka jetuar një popull i ndritshëm hyjnor, me dijeni e kulturë të lartësisë hyjnore, ndërsa ju jeni vetëm imitim apo mbeturina të përziara të tyre...*" (Mbi Legjendën e Atlantidës - nga Sokrati). Edhe kjo dëshmon për Lindjen e Tragjedisë përshkruar nga Niçe, duke krahasuar Satirin, njeriun e pyllit, mishërimin e natyrës, me shtysa dhe prirje të larta njerëzore, plot ëndërrime për të mirë, zëdhënësin e urtësisë së perëndive, me spitullaqin e stolisur e të krekosur që neverit, i cili krijon iluzionin e kulturës, realitetin e rremë të njeriut të kulturuar...

Sot, krahas kërcënimeve që i bëhen njerëzimit, ndërtimi i epokës së re njerëzore po shfaqet si detyrë universale e forcave përparimtare të botës, përballë

terrorizmit, të paralajmëruar edhe me programin e këtij manuali, i cili në esencë lindi dhe po zhvillohet si pasojë e shtimit kritik të diferencës së dy botërave: të pakicës së pasur dhe të shumicës së varfër.

Njeriu i vërtetë beson dhe punon që e vërteta të dalë në shesh. Sa dhe si do të shfaqet, në bazë të ngjarjeve në zhvillim e sipër, me gjasë do të dëshmojë e ardhmja jo shumë e largët.

Forcat e dritës në botë, pasardhësit e popujve të kulturës hyjnore të kohës së vjetër, të stepura nga forcat e errësirës ndër shekuj, nga kahjet e egra dhe anarkike të zhvillimit të botës dhe të civilizimit njerëzor, sipas një ligji të natyrshëm, pritet të zgjohen sërish nga gjumi mijëravjeçar, për të demaskuar e mundur botkuptimin e trashëguar mesjetar duke rindërtuar Epokën e Artë, në shembullin e ndritur të rilindasve etruskë si: Leonardo Da Vinçi, Dante Aligeri, Marin Barleti, Galile Galileu e mijëra pellazgo-etrusko-ilirë të kohës së re.

Ne shqiptarët, sa merremi me vizëllimet marramendëse artificiale të kohës, më mirë do të ishte që të mos i harrojnë veprat e rilindasve tanë të mëdhenj si Naimi: “Punë, punë, natë e ditë, që të shohim pakëz dritë...”. Bota dhe kultura e vjetër arabe kishte arritur kulmin e saj nga i cili u përplas në greminën e varfërisë dhe të shkatërrimit si edhe Kulla e Babilonit; pasojë e harresës, e dhënjes pas epsheve... Rilindja nga obskurantizmi mesjetar dhe rilindasit e mëvonshëm shqiptarë rezistuan gjatë, duke ndriçuar me veprat e tyre madhështore, në mbrojtje të natyrës, të virtyteve njerëzore e kombëtare, të cilat u lanë në harresë nga destruksioni anticivilizues i automatizimit modern të njeriut. Koha e Re duhet të sjellë Rilindjen e Re, të tretë - të vërtetë, të feniksit të ndritur njerëzor nga gjiu i shpërndarë pellazg anëmbanë botës, nga burimet e rebelizmit human sokratian dhe mrrekullia hyjnore apolloniano-dionisiane.

Ish ambasadori amerikan në Greqi dhe Mal të Zi më 1914, Xhorxh F. Wiliams, gjatë kohës kur ishte vëzhgues i Komisionit Ndërkombëtar në Durrës të qeverisë së Princ Vidit, shkroi librin *Shqiptarët*, ku pos tjerash thekson: “*Është larg mendjes që Europa të mund të ushtrojë paqen duke humbur të drejtat e këtij kombi, ose duke e ndarë tokën e tij. Pa u siguruar liria e plotë e shqiptarëve është i pamundur ndalimi i luftës, dhe parimi për të ndarë tokën shqiptare, do të hapi një plagë të re e të helmatisur në politikën e Ballkanit...*” duke apeluar në Amerikën dhe forcat liridashëse të botës, për të shpëtuar popullin shqiptar nga fqinjët grabitçarë, të ndihmuar nga diplomatët e Europës, të cilët, përmes konferencave antishqiptare të pambarim, ia kanë pamundësuar për të qenë i lirë dhe i bashkuar. Ky paradoks merr fuqinë edhe sot, duke e zënë sërish peng të drejtën e shqiptarëve për vetvendosje, ndërkaq “harrohet” kontributi i tyre në të kaluarën, drita e emancipimit dhënë Europës, borxhi i saj ndaj kombit shqiptar, i cili nuk lahet me “ndihma humanitare” por me zgjidhjen e drejtë të çështjes shqiptare.

Metodat dhe teknikat e lansuara politike të këtij manuali - si edhe ato makiaveliane, janë aktuale e të pranishme edhe sot, në jetën e përditshme politike. Si ta cilësojmë gjendjen e shqiptarëve sot: para rikthimit të Kalit të Trojës apo pranë “shpëtimit” nga kriza me kartmonedhat e Mefistofelit? “Askujt nuk do t’i kujtohet të shfuqizojë dekretin e maskuar në fuqi, pasi që ai do të paraqitet si përparim. Agjentët tanë do ta kthejnë vëmendjen në drejtim të arriturave moderne – ne i kemi mësuar njerëzit të kërkojnë gjithmonë modernizmin” . (Seanca e tetëmbëdhjetë - “Skllavërimi për shkak të bukës së gojës”). “Agjentëve tanë ju ka shkuar për dore t’i kënaqin shpirtërat e kufizuar, duke ju premtuar mbështetje dhe të mira në të ardhmen. Mund të kishin pyetur: çfarë mbështetje? Por ata këso pyetje nuk kanë bërë...Shikoni deri ku i ka sjellur kjo mospërfillje, deri në çfarë dezorganizimi financiar kanë arritur, përkundër veprimtarisë çudibërëse të popujve

të tyre”. (“Paafhtësia e paganëve në lëminë e taksimit financiar” – Seanca e njëzet e katërt). Ose “margaritari” tjetër: “Kur ne të qeverisim, e drejta normale e njeriut për shitblerje do të ndalohej...Metoda më e suksesshme për zbatimin e këtij plani është ngritja e taksës dhe e tatimit mbi patundshmërinë; me fjalë të tjera, futja e tokës në borxh. Kjo varësi do t’i mbajë Gojët, pronarë të pasurisë së patundshme, në gjendje robërimi të parezistueshëm. Aristokratët (pasanikët) e tyre, duke mos ditur t’i ndihmojnë vegjëlisë, së shpejti do të shkatërrohen dhe lëshojnë tokat e tyre, të cilat do t’i blejmë ne si dhurata, nëse jo personalisht – së paku për një çast - atëherë nëpërmes njerëzve të thyeshëm”. (“Zbatimi i taksave – zhdukja e begatisë tokësore të aristokracisë goje” – Seanca e njëzet e gjashtë).

“Shtetet nuk janë formuar kurrë nëpërmes zgjedhjeve...Krijohet së pari ekonominë pastaj kujdesu për zgjedhjet...Institucionet burokratike nuk kanë funksionuar kurrë... Demokracitë nuk i bëjnë gjithmonë shoqëritë më civile. Hitleri dhe Musolini, që të dy, kanë ardhur në pushtet përmes demokracisë - por ata e kanë ekspozuar në mënyrë të pamëshirshme shëndetin e shoqërisë me të cilën kanë operuar... Nuk mund t’i vesh revolen një populli në kokë dhe t’i urdhërosh: sillu sikur të kesh përvojën e shteteve të zhvilluara perendimore...Sillu sikur të mos kesh probleme etnike dhe regionale” (R. Kaplan, “The Coming Anarchy”).

A duhen akoma lekcione për të mësuar dhe parandaluar përsëritjen e skenareve të vjetra; duke i dalur vet zot vetes?! Rilindasit tanë do të thërrisnin: shqiptarë, largojuni iluzioneve të rrezikshme; keni rënë shpejt në harresë, në gjumë të rëndë, jeni habitur pas dëfrimeve...! Kujtoni fjalët e Pashko Vasës: “Çonju shqiptarë prej gjumit çonju...” Fjalët e tij janë fjalët e Zotit. “Pa vatan nuk ka dinë as iman”. Lini intrigat, hipokrizitë, cinizmin... Mekën shqiptare e keni fare pranë: tek varrezat e dëshmorëve, te kulla e familjes Jasharaj... Respekti ndaj gjakut të dëshmorëve tuaj është respekt ndaj Zotit.

Ky manuel tregon qartë se si dhe nga vie e keqja, se për të parandaluar të keqen që vie nga jashtë së pari duhet mundur të keqen brenda vetes, se e drejta për vetvendosje dhe pavarësia kombëtare e shtetërore nuk dhurohet por fitohet.

Shqipëruesi

SEKRETI I SUNDIMIT TË BOTËS

Procesverbalet e pleqësisë sioniste

SEANCA E PARË

Projekti i qeverisë së bazuar në forcë

Këtu frazeologjitë nuk kanë vend, këtu bëhet fjalë vetëm për rëndësinë e idesë dhe për ndriçimin e kraha-simeve e të thënjeve. Kështu do të qartësojmë sistemin tonë duke i shqyrtuar ngjarjet nga pikqëndrimi i ynë dhe i Gojëve (1) .

Fillimisht duhet qartësuar, se shumica e njerëzve posedojnë më shumë veti të këqia se sa të mira. Për këtë arsye, efekti më i madh arrihet përmes dhunës dhe frikësimit se sa përmes polemikave të mësuara e bindëse. Çdo njeri është i etshëm për pushtet. Të paktë janë ata që nuk do të pranonin të bëheshin diktatorë, vetëm po të mundnin. Shumë më të paktë janë ata, që nuk do të sakrifikonin interesin e përgjithshëm për interesa personale.

(1)- (Goja, gojët, apo gojimët sipas këtyre Procesverbaleve – Programit të fshehtë të masonerisë sioniste për sundimin e botës: të gjithë të tjerët që nuk janë hebrenj janë paganë dhe kafshë.) - ([Novus ordo Seclorum](#))

Dhuna është drejtësi

Çka e ka stepur dhe udhëhequr këtë masë të shtypshme e konzervuese të cilën e quajmë njerëzim? Që në fillim të jetës shoqërore, njerëzit i janë nënshtruar dhunës së verbër e brutale, pastaj ligjit, i cili është gjitha-shtu dhunë, por e maskuar. Nga kjo konkludohet se, sipas ligjit, drejtësia gjendet në dhunë.

Liberalizmi e vret lirinë e vërtetë

Liria politike është vetëm ide, por jo edhe realitet. Këtë ide duhet ndryshuar në momente të duhura, për të tërhequr fuqinë e masave popullore në organizatën tonë politike, me ndihmën e butësisë së idealizmit të saj, nëse kemi vendosur për ta rrënuar pushtetin. Ky synim lehtësohet, nëse kundërshtari është i infektuar me idenë e lirisë dhe të liberalizmit. Kështu sistemi ynë arrin fitore: sipas ligjit të jetës, sapo që frerët e pushtetit të lëshohen nga një dorë, i merr tjetra, meqenëse fuqia e verbër e popullit nuk mund të mbesë as për një ditë pa udhëheqës... Si pasojë, pushteti i ri zëvendëson të vjetrin, të dobësuar nga liberalizmi, që në lindjen e tij.

Fuqia e jonë e artë

Në ditët tona pushteti ynë i bazuar mbi pushtetin e udhëheqësve liberalë është pushtet i artë.

Anarkia i bën popujt të dorëzohen para nesh

Ideja e lirisë është e perealizueshme, sepse askush nuk di të shërbehet me të në masë të duhur. Mjafton që ta lesh një bataljon ta drejtojë lirshëm vetveten për një kohë, dhe kjo liri do ta bëjë të shpartallohet shpejt. Fillojnë luftrat e brendshme, të cilat, nga konflikte të vogla, shndërrohen në luftëra sociale, të cilat përmbysin shtetet dhe fuqia e tyre shndërrohet në hi e pluhur. Shteti, ose do të dërmohet nga luftrat e brendshme, ose, nga një luftë qytetare, do të bartet në duart e një armiku të huaj: në të dy rastet ai shtet ka mbaruar; i dorëzohet pushtetit tonë.

Despotizmi i kapitalit tonë

Despotizmi i kapitalit tonë i ofron popujve dërrasën e shpëtimit, për të cilën janë të detyruar të kapen për të mos rënë në humnerë...

Nuk ka moral kundër kundërshtarit të brendshëm

Atë, i cili mendon se arësyet tona janë të pamoralshme, do ta pyesja: nëse një shtet ka dy armiq dhe nëse lejohet që kundër armikut të jashtëm të përdoren mjete të llojllojshme strategjike, si p.sh. ruajtja në fsheh-tësi e planeve ofanzive dhe defanzive, sulmet e natës apo sulmet me forca të mëdha, pse këto mjete do të ishin të pamoralshme, kur do të ndërmerreshin kundër armikut tonë më të përbetuar, kundër rrënuesit të pasurisë sonë, kundër konkurrentit tonë për pushtet?

Të mbjellim anarkinë midis masave

A mund të shpresojë një njeri i mënçur dhe i arësyeshëm se do të arrijë të sundojë me masat përmes fakteve dhe arësyeve, duke i hapur rrugë budallalliqeve kontradiktore të budallenjëve, shpirtërisht të cekët, por me aftësi për çoroditur edhe një bataljon të tërë?... Masat udhëhiqen kryesisht me epshe cikrrimtare, me thashetheme, me zakone, me tradita dhe teori sentimentale. Ato ndërhyjnë në mospajtimet partiake, të cilat pamundësojnë çdo marrëveshje, edhe atje ku ato angazhohen seriozisht; sepse masa, e paudhë-zuar me fshehtësitë politike, shumë lehtë krijon botkuptime të pakuptimta, duke mbjellur farën e anarkisë në pushtet.

Në politikë nuk ka moral

Nga ajo që u tha më lartë, rrjedh se politika nuk ka asgjë të përbashkët me moralin. Pushtetari i cili i përmbahet moralit, nuk është politikan mendjemprehtë dhe pozita e tij udhëheqëse nuk është as e qëndrueshme as afatgjate. Ai i cili dëshiron të udhëheqë, duhet të dijë të mashtrëjë dhe të shtiret. Ndershmëria dhe sinqeriteti, si dy cilësi të krenarisë popullore, në politikë quhen dobësi. Ato përmbysin pushtetarët nga pushteti më lehtë se armiku më i egër. Le t'i përmbahen Gojët atyre vetive, por ne nuk guxojmë kurrsesi të lejojmë që ato të na udhëheqin në veprimtarinë tonë.

Forca krijon drejtësinë

Drejtësia e jonë gjendet në forcë. Fjala "drejtësi" shënon kuptimin i cili nuk bazohet në asgjë. Drejtësi mund të thuhet: "më jepni çka dua dhe do t'ju dëshmoj se jam më i fuqishëm se ju". Ku fillon drejtësia? Ku mbaron? Ku mbështetet? Në

shtetet me pushtet të organizuar dobët, ku ligjet dhe udhëheqësi janë të pafuqishëm, me autoritet të dobët për shkak të liberalizmit dhe përpa-rësive të imagjinuara të tij, është e drejta e jonë, që me fuqinë e më të fortit, të sulmojmë dhe rrënojmë regjimin ekzistues dhe institucionet e tij, të vejmë dorë mbi ligjet, të riorganizojmë ndërmarrjet duke u bërë zotërues të tyre.

Papushtueshmëria e Masonerisë (2) së fshehtë (0)

Qeverisja e jonë është e papushtue-shme, sepse është e padukshme, dhe e tillë do të jetë derisa të arrijë fuqi të atillë që asnjë fuqi dhe as komplot të mos mund ta çrrënjosë.

(2) – **Masoneria është organizatë e përfolur e fshehtë e masonëve, patronëve më të pasur të botës** ([EL MASÓN](#)) - ([Piramida masonerike](#))

Qëllimi justifikon mjetin

Nga e keqja e përkohshme, të cilën jemi të detyruar ta zbatojmë, do të vendoset begatia e qeverisjes së përhershme, me të cilën rrjedha e çrregulluar, për shkak të liberalizmit të jetës qytetare, do të kthehet sërish në gjendje normale. Qëllimi justifikon mjetin. Prandaj, le të përqëndrohemi më shumë në atë se çfarë është e vlefshme dhe nevojshme, se sa në atë se çfarë është e mirë dhe morale. Para vetes e kemi planin tonë; rruga e jonë është e shënuar dhe nga ajo nuk mund të largohemi, pa iu ekspozuar rrezikut për të zhdukur veprën e shumë shekujve.

Masa është e verbër

Për të përpunuar mënyrën e përshtatshme të veprimit, duhet llogaritur në poshtërsinë, paqëndrueshmërinë dhe cektësinë e masës, në paaftësinë e saj për të kuptuar kushtet e ekzistencës dhe të mirëqenjes së vet; duhet patur në dijeni se masa është e verbër, imponuese, pa mendim të vetin dhe se ajo përgjon majtas e djathtas, në mënyrë skllavëruese.

I verbëri nuk mund t'i udhëheq të verbërit e tjerë, pa rrezik për të rënë në greminë. Rrjedhimisht, të besuarit tanë - edhe po të jenë gjenialë, por politikisht të paudhëzuar - nuk mund të kërkojnë të drejtojnë me masat, pa i qenë të ekspozuar rrezikut për të humbur tërë kopenë e tyre.

ABC-ja e politikës - Pafuqia e partive politike

Vetëm njerëzit e përgatitur që nga fëmijëria janë të zotë të kuptojnë fjalët e ABC-së politike. Populli i lëshuar vetvetes apo udhëheqësve nga mesi i tij, shkatërron veten me polemika politike partiake, si edhe nga konfrontimet që ato i shkaktojnë, e të cilat burojnë nga dëshira për pushtet e nderime.

A është e mundshme që masat popullore të polemizojnë qetë dhe pa konfrontime, duke bërë punët shtetërore, të cilat nuk guxojnë t'i përziejnë me ato personale? Plani, i ndarë në shumë pjesë, sa ka edhe koka në masë, humb kompaktësinë e vet, bëhet i pakuptueshëm dhe i pazbatueshëm, për shkak të opinionëve të ndryshëm të cilët mund të jipen. Qeverisja e vetme – qeverisja autokratike

Një projekt i qartë dhe i gjërë mund të hartohet vetëm nga një njeri. Ai vendos në rend të gjitha hallkat e mekanizmit të një makine. Nga kjo mund të konkludohet, se në interes të mirëqenjes së një shteti është vendosja e pushtetit në duart e një

individit përgjegjës. Civilizimi nuk mund të mbijetojë pa despotizëm absolut, sepse atë nuk e sjellin masat, por udhëheqësit e tyre. Masa është e egër; ajo këtë e dëshmon në çdo rast. Sapo të arrijë tek liria (ideja e lirisë), e shndërron menjëherë në anarki, në kulm të barbarizmit.

Alkoholizmi – Humanizmi – Jeta e shfrenuar

Shikoni ato qenje të alkoholizuara e shtazarake, të fundosura nga pijet, me të drejtë të pakufizuar të përdorimit. Kjo e drejtë iu është dhënë Gojëve, në të njëjtën kohë si edhe liria. (Tanët, duke kujtuar Kherema (3)-n, nuk shërbehen me këtë liri). Popujt Gojimë, janë të shtazarakuar me alkohol; rinia e tyre është e degeneruar nga mësimet klasike dhe jeta e shfrenuar e parakohshme, në të cilën e kanë futur agjentët tanë, shërbëtorët, nëpunësit etj. në pozita më të mira, si edhe femrat tona, midis të cilave numërojmë edhe ato të Gojëve, të zhytura në luks dhe jetë të shfrenuar.

(3) – Fjalë hebreje: “Ndalesë”.

Parimet dhe themelet e qeverisjes masonike

Forca dhe hipokrizia

Principi i ynë është: forca dhe dyfytërsia. Vetëm dhuna triumfon në politikë, sidomos nëse fshihet me aftësitë e domosdoshme për pushte-tarët. Forca duhet të jetë parimi, dhelpëria dhe dyfytërsia principe të çdo qeverie, e cila nuk dëshiron që të heq dorë nga pushteti para një force të re. Kjo e keqe është mjete i vetëm për të ardhur tek të mirat. Prandaj nuk duhet të frikohemi të përdorim korrupsionin, mashtrimin dhe tradhëtinë, kur mund të na shërbejnë, për të arritur qëllimin tonë. Në politikë duhet ditur se si uzurpohet prona e huaj, për të arritur pushtetin e nënshtrimit.

Terrori

Qeveria e jonë, e cila ecën rrugës së pushtimeve të qeta, ka të drejtë t'i zëvendësojë tmerret e luftës me vrasje të reja, jo aq të dukshme (perfide), por më të suksesshme, për të nxitur terrorin, i cili do të na sigurojë nënshtrimitin e verbër të Gojëve ose dobësinë e tyre. Rreptësia e drejtë dhe e pamëshirshme, janë faktorët kryesorë të fuqisë së qeverisë. Prandaj, për të arritur fitore, është jo vetëm në interesin tonë, por edhe e kemi për detyrë jashtëzakonisht të nevojshme, t'i përmbahemi programit të forcës dhe të hipokrizisë. Fuqia e çdo shkence që bazohet në numra varet sa mjete përdorë. Ne do të fitojmë, jo aq duke zbatuar mësimet tona rigoroze, sa nga vet parimet tona duke i nënshtruar të gjitha qeveritë - Mbiqeverisë sonë. Mjafton të dihet që jemi të pamëshirshëm, duke thyer çdo rezis-tencë.

Liria – Barazia – Vëllazërimi

Që nga koha e zhvillimit të Greqisë së Vjetër, ne të parët kemi brohoritur: “Liri”, fjalë të cilën mëpastaj e kanë përsëritur aq shpesh papagajt e pavetëdijshtë, me të cilën janë shërbyer duke hequr botën e mirëqenjes e të lirisë së vërtetë individuale dhe mbrojtjen e kësaj lirie nga dhuna e masës. Gojët e tillë, të ashtuquajtur të mençur dhe të ditur, nuk kanë mundur të kuptojnë sa abstrakte

janë këto fjalë, të cilat i kanë dëgjuar nga të gjitha anët: nuk janë kujtuar se në të vërtetë nuk ka liri, siç nuk ka as barazi, pasi që vet natyra ka përcakruar jobarazinë mendore, të karakterit, të aftësive; nuk kanë vërejtur se politika e jonë i ka hedhur jasht jetës së tyre të zakonshme, në rrugë të sundimit (4) tonë. Edhe budallai mund të qeverisë, nëse është i udhëzuar në politikë, ndërsa i paudhëzuari, edhe sikur të jetë gjenial, do të humb në rrugët që ne ia tregojmë.

(4) – Nuk janë pajtuar midis por, bile janë konfrontuar njëri me tjetrin.

Ne e kemi varrosur monarkinë

Në këtë parim është bazuar qeveria e dinastisë së mbretërve tanë, kështu që i biri ka qenë i udhëzuar nga babai i vet në fshehtësitë politike, në fshehtësitë deri tek të cilat nuk ka guxuar të vijë askush. Gojë të kanë humbur kuptimin e trashëgimisë së bartjes së pushtetit, dhe kjo humbje ka mundësuar suksesin e misionit tonë.

Eliminimi i beneficioneve të fiseve Goje

Brohoritjet tona: “Liri, Barazi, Vëllazëri” - falë agjentëve tanë të verbër - kanë sjellur në radhët tona legjione të tëra, nga të gjitha anët e botës, të cilët me entuziazëm kanë bartur flamurin tonë. Por, në realitet, këto fjalë kanë qenë fjalë kafshuese me të cilat sistematikisht është dobësuar mirëqenja e Gojëve, duke rrënuar paqen, harmoninë dhe solidaritetin e bashkëpunimit sipas ligjit dhe themelet shtetërore të tyre. Më vonë do të shihni se pikërisht kjo ka mundësuar fitoren e sistemit tonë të pushtimit të qetë të botës. Pastaj kemi arritur t’ju ndërprejmë të gjitha privilegjet, si edhe vet qenjen e aristokracisë së Gojëve, të asaj aristokracie e cila ka qenë mbrojtëse e popullit dhe atdheut kundër veprimeve tona.

Aristokracia e re

Në gërmadhat e aristokracisë së gojëve ne kemi ngritur aristokracinë tonë të re të përkrahësve tanë, duke patur për kriter shkencën dhe pasurinë.

Të llogariturit në dobësi dhe epshe

Fitorja e jonë është e lehtësuar sepse në raport me njerëzit shumë të nevojshëm, jemi mbështetur në vetitë më të ndieshme të natyrës njerëzore: numrat, etjen për uzurpim, nevojat materiale. Secila nga këto dobësi në vete ka mjaftuar të eliminojë çdo iniciativë personale duke ia dorëzuar vullnetin atij që ia blenë punën.

Liria e kuptuar gabimisht na dorëzon pushtetin

Kuptimi abstrakt i lirisë na mundëson t’i bindim masat se qeveria e tyre nuk është asgjë tjetër, përpos një punëdrejtues i pronarit të tokës – i popullit, dhe se ajo mund të ndërrohet si dorëzat e harxhuara. Kjo mundësi e ndërrimit i ka bërë të na dorëzohen. Zgjedhja e tyre ka mbetur praktikisht në dorën tonë.

Maska politike

Do të filloj me atë që tanimë është thënë. Kujtoni ju lutem se si qeveritë dhe popujt e Gojëve kënaqen me formën e jashtme të gjërave. Si pra ata do të mund të zbulojnë kuptimin e brendshëm(1), kur udhëheqësit e tyre ëndërrojnë vetëm për dëfrime dhe kënaqësinë e të mirave materiale. Kjo ka një rëndësi të madhe për të bërë llogaritë tona, duke e zhvilluar politikën tonë. Tani do të shqyrtojmë çështjet e pushtetit, të lirisë së fjalës, lirinë e mendimit, të drejtën e organizimit shoqëror, barazinë para drejtësisë, paprekshmërinë e pronës, të vendbanimit, të tatimit dhe idenë e tatimit të fshehtë. Asnjëra nga këto pyetje nuk guxon të debatohet publikisht para popullit; dhe as që duhet numëruar para tij të gjitha elementet tona bazë. Rëndësia e kësaj heshtje qëndron në atë që, duke kaluar heshtur para këtyre parimeve, ruajmë lirinë e veprimit tonë. Kjo na mundëson të shkyqim ndonjërin nga ato elemente më-pastaj, në çdo rast të volitshëm, pa e hetuar askush këtë. Përndryshe, po t'i publikonim, do të duhej t'i merrnim me rezervë.

(1) – Strategjinë tonë, duke prezentuar parimet e së drejtës moderne, sikur ne e kemi pranuar vetë, pa hyrë në detaje.

Suksesi është i garantuar

Populli në një mënyrë të veçantë i nderon ata që në vete personifikojnë fuqinë. Për çdo akt të dhunës brohorisin: “Vërtet është i poshtër, por i zoti! Me çfarë vetbesimi artificial ka luajtur rolin!”

Ne synojmë që, pa u vërejtur, t'i detyrojmë të gjithë popujt për të ndërtuar vepra të reja, me të cilat përgatisim planin, për të rrënuar plotësisht rendin ekzistues, të cilin do ta zëvendësojmë me mbretërinë tonë dhe me ligjet e saj. Prandaj, duhet të sigurojmë mbështetjen e kësaj force, e cila është e përbërë (“aq na bën?”) nga agentët tanë – “kryeministrave” modern të shteteve. Këtu forca eliminon të gjitha pengesat të cilat na dalin përpara.

Grushtshteti

Kur të zbatohet grushtshteti, popuj-ve do t'ju themi: “Gjithëçka shkoi keq për ju. Ju keni rënë në hall të madh. Ne do t'i zhdukim shkaqet e halleve tuaja: kombësitë, kufijtë, dallimet valutore. Vërtet, duke mos i kuptuar arësyet tona, mund të na gjykoni; por, që të jeni të drejtë, shqyrtoni së pari çka ju ofrojmë...” Atëherë ata do të na mbajnë mbi supë me entuziazëm, gëzim dhe shpresë. Votimet do të na përgatisin terrenin për t'i shtyer në to edhe njerëzit më të thjeshtë, duke organizuar kudo që të jetë e mundur grupe dhe shoqëri të veçanta. Votat e masave do ta luajnë rolin vendimtar, duke na bërë shërbimin e fundit: konfirmimin e ligjeve tona.

E drejta e përgjithshme e votës

Për të fituar shumicën absolute, duhet ta jetësojmë, pa dallime, të drejtën e përgjithshme të votës së lirë. Këtë shumicë nuk do të mund ta fitonim tek shtresa e shkolluar dhe e pasur.

Fuqia e jonë rrënon familjen nën despotizëm

Ne jemi përpjekur që t'i pengojmë Gojët të mos shërbehen me këtë lloj lufte kundër kryengritjeve. Pandaj, jemi përpjekur që me ndihmën e shtypit të përhapim kuptimin e domosdosë që kryengritësit të dëno-hen me dënime të veçanta edukative, duke i reklamuar në të njejtën kohë mundimet që po bëhen për mirë-qenjen publike. Një reklamë e tillë ka rritur numrin e të vuajtsve liberalë për të drejtën e të ashtuquajturës të vërtetë, duke tërhequr mijëra dele gojime në radhët e robërve tanë të dëgjueshëm.

SEANCA E NJËZETË E NJËTË

Misteri kohë

Nga të gjitha që kam thënë, jam munduar që të përshkruaj sa më mire e saktë misterin e ngjarjeve të kaluara dhe të sotme. Të gjitha rrjedhin nga majat tona për të krijuar eksplozionet e njëpasnjëshme të ngjarjeve të ardhshme. Ju kam treguar gjithashtu misterin e ligjeve financiare, raportet dhe operacio-nalizimin e tyre. Kësaj nuk kam për t'i shtuar diç më të rëndësishme.

Ari mijëravjeçar – themel i mirëqenjes në të ardhmen

Ju e dini se ne e kemi në dorë fuqinë më të madhe - arin. Për 48 orë ne mund të nxjerrim nga arkat tona aq sa na nevojitet. A ka nevojë të dëshmojmë akoma se qeveria e jonë është e përcaktuar nga vet Zoti për të udhëhequr me botën? A është e mundur që me këtë pasuri të mos arrijmë të dëshmojmë se e keqja kalimtare, të cilën kemi qenë të detyruar ta shkaktojmë, ka dhënë këtë efekt dobiprurës?

Që të gjitha do të vijnë në rend, por jo përmes dhunës së përhershme. Ne do të dëshmojmë menjëherë se ne jemi mirëbërësit të cilët ia kanë kthyer botës mirëqenjen e vërtetë dhe lirinë individuale. Kjo liri do të mbrohet nga çdo sulm me kusht që që të respektohen ligjet të cilët ne i vendosim. Të gjithë do ta kenë paqen në punë, qetësinë dhe dinjitetin në marrëdhëniet reciproke. Ne do të dëshmojmë qartë se liria nuk përbëhet prej shkapërderdhjes dhe as në të drejtën e shkapërderdhjes, ashtu siç edhe dinjiteti e fuqia e njeriut nuk përbëhet në të drejtën që secili të shpallë parime, kuptimin e të cilave nuk e njeh; se liria kurrsesi nuk e jep të drejtën për ta hutuar veten dhe të tjerët, duke shkaktuar çrregullime me fjalime të tepërta nëpër mbledhje të zhurmshme - por se ajo bazohet në moslëndimin e individit të ndërgjegjshëm për t'i respektuar ligjet sociale; se dinjiteti i njeriut gjendet në të kuptuarit e të drejtave të tij dhe të

kufijve të tyre, dhe se ky dinjitet kërkon respektimin e të tjerëve dhe ndalon imagjinatën fantastike të individualizmit egoist.

Autoriteti i pushtetit

Pushteti i ynë do të jetë i famshëm sepse do të jetë i fuqishëm. Ai do të qeverisë pa përfillur oratorët dhe llafazanët që paraqesin utopitë e tyre, me të cilat ata vezullojnë në emër të parimeve. Pushteti i ynë do të jetë studimi i rendit në të cilin gjendet fshehtësia e mirëqenjes popullore. Autoriteti i këtij pushteti do t'i frymojë popujve respektin mistik para të të cilit do të përkulen. Fuqia e vërtetë ruan gjithmonë të drejtën e vet. Askush nuk do të guxojë t'i afrohet asaj me synim për t'ia marrë qoftë edhe atomin më të vogël të autoritetit.

SEANCA E NJËZET E DYTË

Kufizimi i prodhimit të gjërave luksoze

Në mënyrë që njerëzit t'i përshtaten dëgjueshmërisë, ata duhet edukuar mbi thjeshtësinë e cila lind vitalitetin. Për këtë arsye ligjet tona do të kufizojnë prodhimin e sendeve lukso-ze të cilat e dobësojnë njeriun dhe nxisin lakminë. Kështu do të përmirë-sojmë sistemin e prishur të konkurencës me të cilin nxitet luksi.

Themelimi i industrisë shtëpiake

Ne do të rivendosim industrinë e vogël, që do të rrisë rëndësinë e tyre ndaj ndërmarrësve të mëdhenj, të cilët janë krekosur për së tepërmi, si pasojë e fitimeve të mëdha, dhe të cilët shpesh zgjojnë frymën e masave kundër nesh.

Eliminimi i varfërisë

Përparësia kryesore e kësaj mase është se populli i cili posedon industrinë e vogël nuk di për varfëri. Ai i përmbahet rendit dhe qeverisë së fortë, detyra e së cilës është ta mbrojë besimtarin e vet nga vështirësitë të cilat mund t'ia shkaktojnë të tjerët. Është vërtetuar se nuk ka më vdekjeprurëse për shtetin se varfëria. Kemi dhënë prova se me kalimin e pushtetit në duart tona ajo do të zhduket.

Ndalimi i alkoolizmit

Dehja alkoolike do të ndalohet dhe dënohet sipas ligjit, si krim kundër dinjitetit njerëzor të cilin e përul alkooli gjer në marrëzi.

Përsëris se njerëzit i nënshtrohen verbërisht vetëm pushtetit të fortë, të organizuar dhe të pavarur nga ata, në të cilin i ndiejnë prangat, por edhe mbrojtësin e mbështetësin kundër vuajtjeve të tyre sociale.

Njerëzit fare pak preokupohen që sovrani i tyre ka shpirt engjullor. Ata e dijnë se cilësitë e tij mbështeten në forcë dhe pushtet.

Vdekja dhe ringjallja e shoqërisë

Gjatë ndërrimit të pushtetit Sovrani i ynë, para së gjithash, do të shuajë flakën përbindëshe të anarkisë në qeveri, të krijuar nga shoqëritë e demoralizuara nga ne, të cilat fillimisht patën fituar krihë të pushtetit perandorak. Prandaj shoqëritë e tilla duhen shkatërruar për të ringjallur të renë, ushtrinë e përgatitur e cila do të dijë përse lufton: kundër helmit të vet, anarkisë.

Mbreti ynë - i zgjedhuri i Zotit

Ky i zgjedhur i Zotit, i dërguari i Zotit, do t'i zbrapsë të gjitha forcat e marra të cilat udhëhiqen nga epshet e jo arësyja, nga egërsia e jo njerëzish-mëria; ato forca të cilat janë të prirura për plaçkitje dhe uzurpime në emër të parimeve të drejtës dhe drejtësisë (lirisë).

Këto forca e kanë rrënuar gjithandej rendin social por roli i tyre do të përfundojë, falë rënjes së tyre, posa të vendoset fronti i mbretit hebrej. Në çastin kur të arrihet ky qëllim, do të duhet të pastrojmë rrugën e ushtrimit të pushtetit tonë nga çdo pengesë.

Atëherë do t'i themi popullit: "Falenderoni Zotin dhe përluni para atij që mban në ballë vulën e parapërcaktimit, për të cilin, vet Zoti e ka udhëhequr yllin e tij ndër shekuj".

SEANCA E NJËZET E TRETË

Si të forcohet pushteti i dinastisë së Davidit

Sot do të kaloj në çështjen e mjeteve të cilat do të përdoren për të përforcuar muskujt dinastike të mbretit David në brendësitë më të thella të tokës. Ne do t'i përmbahemi parimeve të njejta të cilat dijetarëve tanë i kanë siguruar drejtimin mbi punët botërore, gjegjësisht drejtimin e edukimit të mendimit njerëzor dhe orientimin e tërë politikës botërore.

Shumë anëtarë të familjes së Davidit do të përgatiten për të mbretëruar dhe qeverisur me popujt. Popujve do t'ju përgatisim mbretërit, ndërsa pasardhësit e tyre do të zgjidhen jo sipas trashëgimisë heredite, por sipas aftësive të tyre. Ata do të udhëzohen në fshehtësitë më të mëdha politike, dmth. në planet tona të qeverisjes, duke pasur kujdes që askush të mos njihet me to, përpos atyre vetë. Detyra e qeverisjes nuk mund t'i besohet atyre që nuk janë të udhëzuar në fshehtësitë dhe mënyrën e zbatimit praktik, pa e kuptuar qëllimin. Vetëm këtyre do t'ju tregohet se si duhet bërë zbatimi praktik i planeve të hartuar, duke e krahasuar përvojën e arritur gjatë shekullit, duke i shqyrtuar lëvizjet politiko-ekonomike të shkencave sociale dhe konkluzionet e bëra nga këto shqyrtime. Vetëm ata do ta njohin shpirtin e vërtetë të ligjit të cilin e ka themeluar vet natyra për të rregulluar marrëdhëniet ndërnjë-zore.

Mbreti ynë dhe këshilltarët e tij

Planet e sotme të aksionit, sidomos ato të ardhshëm, do të jenë të panjohur edhe për ata njerëz që quhen këshilltarë të afërt të mbretit. Vetëm mbreti me mësuesit dhe inspiruesit e tij do të dijë se çfarë është përgatitur për të ardhmën.

Mbreti ynë - personifikim i fatit

Do ta shohin të gjithë se Sovrani është zot i vetvetes, me vullnetin e tij të papërkulshëm. Ai do të jetë personifikim i fatit në rrugë të panjohura. Duke mos ditur qëllimin e urdhëresave të mbretit, askush nuk do të guxojë që t'i vendosë pengesa atij, të cilit gjithçka i është përgatitur në fshehtësi.

Është e qartë se truri i Sovranit duhet medeomos t'i përgjigjet nivelit të madhësisë së planit shtetëror. Prandaj ai do të ngritet në fron vetëm pasi që të ketë kaluar provimin intelektual nga dijetarët tanë.

Që populli ta njohë dhe dojë mbretin e vet, mbreti duhet t'i flasë atij në vende publike, sepse vetëm ky është mjete i cili do ta përforcojë unitetin midis këtyre dy pushteteve botërore, të cilat ne i kemi ndarë nëpërmes frikësimit, sepse kjo na është dashtë për të vendosur veten tonë në mes tyre, për të ndikuar duke e orientuar secilin prej tyre veç e veç.

SEANCA E NJËZET E KATËRT

Programi financiar

Sot do të flas mbi programin financiar, të cilin e kam lënë për fund të raportit tim, sepse kjo është pika kryesore dhe më e vështirë, vendimtare për planet tona. Duke filluar këtë çështje thërras kujtesën tuaj, për atë që tanimë kam thënë; se numrat do të vendosin mbi rezultatin e punës sonë.

Kur të vijmë në pushtet dhe për ta mbajtur pushtetin tonë autokratik, ai duhet të ruhet për të mos e ngarkuar popullin me tatime të reja. Nuk duhet harruar për asnjë çast, se mbreti duhet luajtur rolin e babait, të shtëpiakut, Patriarkut tonë hebrej.

Por, meqë organizata e jonë udhëheqëse kushton shumë, duhet gjetur mjete financiare, të domosdoshme për ekzistencën e saj. Prandaj, duhet studjuar me shumë mend çështjen e barazpeshës. Meqenëse Sovrani në shtetin tonë është pronar i ligjshëm i të gjitha të mirave të shtetit të tij, ngritja e mjeteve nga kapitali do të mund të shërbejë për të rregulluar qarkullimin e parave në shtet.

Për të mos pasur ankesa nga detyruesit e pasur të tatimit ndaj taksave të cilat i godasin, do t'ju tregohen llogaritë detale mbi dedikimin e hargjimeve të bëra, përpos llogarisë së fondit të fshehtë, të cilat përdoren en bloc për nevojat e fronit dhe të administratës. Sovrani nuk do të ketë pronë personale, pasi që atij i përkasin të gjitha të mirat shtetërore; përndryshe, këto dy kuptime do të ishin në kundërtënie me njëra-tjerën. Fakti se ka pronë personale, do t'ia përjashtonte të drejtën e posedimit me të gjitha.

Arka shtetërore

Banka shtetërore është e detyruar të ruajë fondin rezervë me sasi konstante të mjeteve, dhe në rast se nga tatimi mblidhet më shumë se nga kjo sasi, teprica duhet të kthehet në qarkullim për t'u përdorur për punët publike. Fakti se nisma për këto punë i përket qeverisë, punëtorit do t'ia lidhë duart për interesa të shtetit dhe të personelit të sovranit, i cili i personifikon ato në vetvete. Një pjesë nga kjo shumë do të përcaktohet për shpërblimet të cilat do t'i ndahen zbuluesve dhe prodhuesve, sepse përpos sasisë së caktuar (e cila do të llogaritet në të gjërë), asgjë nuk do të ngelë në arkë, as fondi më i vogël. Paraja është për të qarkulluar, dhe çdo stagnim e dëmton funksionimin e mirë të mekanizmit shtetëror, të cilit paraja i shërben si kallauz. Nëse kallauzi mungon, makina mund të ketë pasoja.

Duke vendosur qarkullimin e obligacioneve në vend të një pjese të parave të imta, zbatohet ndalesa, pasojat e së cilës vërehen që tani.

Trezori shtetëror

Do të themelojmë trezorin shtetëror, tek i cili sovrani çdo moment do të mund t'i gjejë llogaritë e gatshme të të ardhurave shtetërore, përpos për muajin paraprak, të cilat akoma nuk do të tregohen. Personi i vetëm i cili nuk do të ketë interes të vjedhë arkën e shtetit është pronari i tij, e ky është sovrani. Për këtë vetëm kontrolla e tij mund të pengojë humbjen dhe përdorimin pa kriter të tij.

Ndalimi i shpenzimeve të reprezentacionit

Do t'i ndalojmë të dalat dhe letrat-etiketat e tjera me shkrim të cilat sovranit i marrin kohën e çmuar për t'u marrë me çështje serioze. Vetvetiu nënkuptohet se sovrani ynë për asnjë moment nuk mund të jetë i preokupuar me detyra në drejtorinë e tij. Po të përkujdesej me etiketat dhe të hyrat, të cilat sovranin e shndërrojnë në kukëll, puna e tij do të pamundësohej. Sovrani i ynë nuk do të shkapërderdhë fuqinë e tij në llogari të të vardisurve, të cilët nuk mendojnë për interes të shtetit, por për profitin e tyre personal.

Frenimi i jetës ekonomike

Për të shkaktuar kriza ekonomike tek Gojimët, mjafton të tërheqim paratë nga qarkullimi. Kapitali i madh është grumbulluar pasi që i është marrë shteteve, të cilat pastaj kanë qenë të detyruar të kërkojnë kredi. Pagesa e kamatave në këto kredi i ka ngarkuar financat shtetërore, duke shkaktuar robërimin e shteteve ndaj kapitalit tonë. Koncentrimi i industrisë në duar të kapitalistëve, të cilët e kanë mbytur industrinë e vogël, i ka thithur të gjitha fuqitë, së pari të popullit, pastaj edhe të shteteve.

Qarkullimi i parasë

Emitimi i tanishëm i parave të imta nuk i përgjigjet sasisë së shpenzimeve për kokë dhe nuk mund t'i kënaqë nevojat e punëtorëve. Ky emitim tek ne do të jetë në proporcion me shtimin e popullsisë sonë. Fëmiju i posalindur do të konsiderohet si një njësi më shumë, të cilin duhet kënaqur si të rriturin. Përkundrazi, çdo vdekje do të tërheqë me vete zvogëlimin nga shuma e tërë ndaj shpenzimit personal, të cilën e ka pasur i ndjeri sipas rrjedhës së kohës dhe nevojave individuale. Ky revizion i dhënjes së parave është një çështje kapitale për tërë njerëzimin.

Paraja e bazuar sipas vlerësimit të punës

Ju e dini se njësi e arit ka qenë fatale për shtetet të cilët e kanë përvetësuar, sidomos për shkak se ka zvogëluar paratë në qarkullim. Prodhimi i parasë së artë na ka dhënë mundësinë për ta mbledhur për vete, duke e zvogëluar edhe më shumë qarkullimin e parave.

Paraja e imtë në të ardhmen

Ne do të kemi një sistem plotësisht tjetër: do të vendosim paranë e bazuar mbi vlerën e punës. Asgjë nuk pengon se a është ajo prej letre a druri, sepse paraja, si shenjë e ndryshimit, nuk guxon të ketë vlerë të brendshme, por vetëm shërben për të shënuar çmimin e gjësendeve të cilët përdoren për nevoja normale njerëzore, e jo për vathët e njerëzve. Njerëzit shpenzojnë fuqinë e tyre për të arritur këtë vlerë, të cilën e kanë përvetësuar një grup kapitalistësh, për t'i sunduar dhe robëruar njerëzit tjerë.

Drejtoria financiare tek Gojët

Por, kur ne të vijmë hapur në pushtet, do t'i ndryshojmë themelet financiare të Gojëve. Ato ne i mendojmë në formën e cila nuk do të zgjojë dyshimin e askujt. Do të vërtetojmë domosdonë e këtyre ndryshimeve duke e lansuar në opinion gjendjen e parregulluar financiare të Gojëve. Do të tregojmë se si çrregullimi financiar i tyre i ka sjellur deri aty, sa që më nuk kanë buxhet të përhershëm. Ata përcaktojnë llogarinë e rregullt e cila rritet çdo vit, nga këto arsye: kjo llogari, siç e shihni, mjafton vetëm për gjysëm viti; votohet për llogarinë plotësuese e cila shpenzohet për tre muaj, dhe gjithçka kokludohet me llogarinë plotësuese, dhe atë me likuidim. Pasiqë llogaritja e një viti vlerësohet sipas llogarisë së vitit të paraparak, aprovohet rritja shtesë deri 30% në vit, me çka për çdo 10 vjet buxheti trefishohet. Me këtë metodë, e cila shteteve i lejon mosbregosjen, arkat e tyre mbesin të zbrazëta. Pason periudha e kredive të cilat e hanë mbetjen, pason bankroti i shteteve. Ky sistem i drejtimit financiar me të cilin i kemi mësuar Gojët, për ne nuk vlen.

Kreditë shtetërore

Çdo kredi dëshmon dobësinë e shtetit dhe paaftësinë e sovranëve për t'i kuptuar të drejtat e tyre. Ata nuk dijnë t'i plotësojnë nevojat financiare nëse nuk shtrijnë dorën dhe lutën për mëshirë nga bankierët tanë. Kreditë e jashtme janë ushujza të cilat nuk do ta lëshojnë organizmin shtetëror derisa vet shteti të mos i heqë qafe. Mirëpo, shtetet nuk i heqin ato, përkundrazi, ato i tërheqin gjithmonë, për të shumëzuar kontributin të cilin ia paguajnë bankierëve tanë. Për këtë ato detyrimisht do të vdesin nga humbja e gjakut, të cilin ia pinë vetvetes.

Le të shqyrtojmë pra, çka është krediti, e në veçanti, krediti i jashtëm.

Krediti është dhënja e letrave me vlerë obligative shtetërore, sipas të cilave shteti do të paguajë kamatat e caktuara të kapitalit të dhënë. Nëse krediti është me 5% kamatë, shteti, brenda 20 vjetëve, nga kamatat do të humb aq sa është krediti; brenda 40 viteve, sasia e humbur do të dyfishohet; brenda 60 viteve tre-fishohet, ndërsa borxhi mbetet siç ka qenë në fillim. Sipas kësaj llogarie, është e qartë se shteti, me sistemin e tatimit të përgjithshëm, obliguesve të pafat të tatimit ua merr edhe metelikun e fundit, për të mbuluar kamatat e kapitalistëve të huaj, tek të cilët ka huazuar paratë, në vend se t'i marrë në vendin e tij, e të mos paguajë kamata të cilat janë njësoj si edhe borxhet e përjetshme.

Derisa kreditë kanë qenë popullore, Gojët vetëm sa i kanë bartur ato nga xhepi i të varfërit në xhep të të pasurit. Prej kohës kur ne i kemi blerë njerëzit, nëpërmes të cilëve kanë arritur kreditë e jashtme, e gjithë paraja ka ardhur në arkat tona dhe të gjithë gojimët na kanë paguar borxhet, duke mos dyshuar fare në këtë.

E vërteta është se, mendjelehtësia e pushtetarëve gojimë, korrupcioni i ministrave të tyre, apo mosnjohja e çështjeve financiare, sa i përket punëve shtetërore, ka shkaktuar nënshtrimin e popujve ndaj nesh, duke i detyruar të krijojnë borxhe

tek ne, nga të cilat nuk do të mund të lirohen kurrë. Kjo ka shkaktuar vendosjen e të gjitha çështjeve financiare nën drejtimin tonë. Por duhet ditur se kjo punë na ka kushtuar me shumë mundime, kohë dhe para.

Kreditë e ardhshme shtetërore

Kur të vijë koha e jonë, nuk do të durojmë pengesa të qarkullimit të parasë. Rrjedhimisht, nuk do të ketë obligacione shtetërore me kamata, pagesa e të cilave do t'i thithte të gjitha të ardhurat, në llogari të ushujzave parazite. Të drejtën e dhënjes së obligacioneve do ta kenë vetëm shoqëritë industriale, të cilat do të mund t'i paguanin kamatat nga të ardhurat e tyre, ndërsa shteti i cili huazon para vetëm për shpenzimet e veta, dhe jo për të prodhuar ope-ratione, nuk do të benificohet.

Vlerat industriale

Shteti i ynë do t'i blejë vlerat industriale dhe tek borxhliu do të bëhet kujdestar i cili do të marrë kamatën nga paratë e veta, në vend se të paguajë për to. Kjo masë do të pengojë çdo ngecje në qarkullim të parasë dhe nuk do të nxisë më moskujdesin dhe përtacinë, të cilat kanë qenë të dobishme gjatë regjimit gojim, por të cilat nuk guxojnë të ekzistojnë më, kur ne të qeverisim.

Paaftësia e Paganëve në lëminë e taksimit financiar

Tanimë jeni në dijeni për korrupsionin, ultësinë dhe marrinë e trurit shtazarak të Gojëve, kur të mendohet se ata as që mendojnë në atë se si një ditë do t'i akuzojë bota, për kreditë me obligim për t'i paguar kamatat dhe borxhin të cilat i kanë marrë tek ne, dhe se as që kanë dyshuar se, për të na kthyer ato para me kamata, duhet të nxjerrin paratë e xhepit!

Do të ishte më e thjeshtë për ta, sikur t'i tërhiqnin këto para nga obliguesit e tyre kreditorë, në vend se të na paguajnë borxhin në shumat të cilat për shkak të kamatave rriten çdo vit. Por ne kemi ditur t'i paraqesim kreditë në formën që ata i kanë konsideruar të përshtatshme. Kjo përsëri dëshmon për përparësinë gjeniale të shpirtit tonë. Metodatat tona financiare, të paraqitura në çastin e duhur, në dritën e ndritshme të përvojës shekullore, për të cilën shtetet gojime na kanë dhënë material të bollshëm, do të theksohen me qartësinë dhe precizitetin e tyre, duke treguar efektin e sistemit tonë të ri. Ky sistem do të eliminojë të gjitha keqpërdo-rimet të cilat na kanë shërbyer për të shkatërruar Gojët, por të cilat nuk do t'i durojë qeveria e jonë. Kështu do të përcaktojmë që as Sovrani as nëpunësi më i vogël, nuk do të mund të abuzojë as me shumën më të vogël, dhe as ta përdorë për qëllime tjera nga ato të parapara me planin tonë.

Është e pamundur të qeverisësh pa një plan të definuar saktë: edhe trimat, por edhe njerëzit me zemër të forte, do të vdisnin gjatë rrugës, po të lëshoheshin nëpër rrugë të panjohura dhe pa rezerva të mjaftueshme.

Sovranët gojimë, të cilët dikur kemi synuar t'i dridhim nëpër shërbime publike dhe punë shtetërore nëpërmes pranimeve dhe dëfrimeve, kanë qenë vetëm perde e qeverisë sonë. Dhe, vërtet, të dhënat dhe raportet e simpatizuesve nga rrethi i tyre i kanë përpunuar agjentët tanë, dhe atyre gjithnjë ju ka shkuar për dore t'i kënaqin shpirtrat e kufizuar, duke iu premtuar mbështetje dhe të mira në të ardhmen. Mund të kishin pyetur: çfarë mbështetje? Por ata këso pyetje nuk kanë bërë, duke lexuar këto raporte dhe të dhëna. Shikoni se deri ku i ka sjellur kjo

mospërfillje, deri në çfarë dezorganizimi financiar kanë arritur, përkundër veprimtarisë çudibërëse të popujve të tyre.

SEANCA E NJËZETË E PESTË

Kreditë popullore

Për t'i plotësuar raportet e mia nga seancat paraprake, do t'i shtoj edhe disa shpjegime të cilat i përkasin kredive popullore. Nuk do të flas më asgjë mbi kreditë e jashtme, sepse ato nuk do të ekzistojnë në shtetin tonë. Kreditë për Gojët nuk do t'i ushqejnë më arkat tona nga paratë e popujve të tyre.

Për të mbledhur mjete financiare dyfish e trefish më të mëdha se sa ato që ju kemi huazuar Gojëve, për të cilat as që kanë pasur nevojë, jemi shërbyer mjaft me indolencën dhe korrupsionin e qeveritarëve të tyre. Kush do të mund të bënte më shumë për ne?

Tani do ta paraqes më detalisht çështjen e kredive të brendshme. Duke paralajmëruar emisionin e kredive, qeveria mbledh parapagesën për blerjen e titullarëve në profit, të cilët nuk janë asgjë tjetër përpos çeqe. Për të qenë të disponueshme për të gjithë, atyre ju caktohet vlera prej 100 gjer 1000. Aq më shumë që, nënshkruesit e parë gëzojnë levër-dinë e uljes së çmimit nga sasia e shënuar. Menjëherë të nesërmen bëhet rritja artificiale e valutave të shpërndara, me arësyetim se po grabiten nga të gjithë. Për disa ditë dhe të gjitha arkat shtetërore do të mbushen, dhe nuk do të dijnë çka të bëjnë me të gjitha ato nëshkrime. (Po pse i kanë pranuar aq shumë?). Pra, sasia e nënshkrimeve do të tejkalojë shumë kredinë e kërkuar. Efekti i kërkuar është arritur me vet këtë fakt. Kjo është njësoj sikur të thuhej: "shikoni se çfarë besimi gëzojnë letrat me vlerë të qeverisë!"

Borxhet shtetërore dhe taksimi

Por kur loja të luhet, mbetet para pasivës së rëndë.

Për të paguar kamatat, duhet filluar me kredira të reja, të cilat, në vend që ta zvogëlojnë, e ngrisin borxhin kryesor. Kur krediti shpenzohet, duhet mbledhur tatimet e reja, jo për likuidim të kreditit, por për pagesën e fitimit. Këto tatime pra, janë pasiva e cila mbulon pasivën tjetër.

Zvogëlimi i kamatimit në kredi

Më në fund vie çasti i zbritjes. Por, kjo vetëm zvogëlon kamatën, por nuk fshin edhe borxhin. Aq më parë që nuk mund të bëhet ulja e tepruar e kamatës pa lejen e kredidhënësit. Duke paralajmëruar uljen, kthimi i depozicionit i ofrohet atyre që nuk pranojnë uljen e propozuar. Nëse të gjithë do të kërkonin pagesën, qeveria do të binte në kurthin e vet, duke u gjetur në pozitë të borxhliut të pazgjidhshëm. Për fat, Gojët, duke mos i kuptuar financat, gjithmonë kanë preferuar më parë humbjen në ndërrim të uljes së kamatës, se sa t'i kërkojnë paratë e veta. Kështu i kanë dhënë mundësi qeverive të veta që t'i mbujonë deficitet e tyre të cilat janë numëruar në miliona. Por sot, me kreditë e jashtme, nuk mund të luajnë lojëra të tilla, sepse Gojët e dijnë se, nëse paralajmërojnë zvogëlimin e kamatave, ne do të kërkonim pagesën e kreditit kryesor.

Pamundësia e shtetit për të paguar borxhet

Bankroti që do të pasonte, do t'i tregonte më së miri popujve se nuk ekziston kurfarë interesi i përbashkët midis tyre dhe qeveritarëve të tyre. Tani po ju tërheqim vëmendjen posaqërisht në atë që vijon:

Përforcimi i kredive popullore – Kamatat e përhershme

Tani të gjitha kreditë popullore janë përforcuar me të ashtuquajturin borxh pa interes, dmth. me borxh i cili paguhet pas një afati të shkurtër apo të gjatë. Ky borxh përbëhet nga shuma e paguar për bankën e kursimit ose arkave tjera për ruajtje. Meqë këto fonde i mbesin qeverive në disponim, ato shpenzohen për pagesën e kamatave të kredive të jashtme dhe kompensohen me vlerën e njejtë të shumës së obligacioneve shtetërore. Këto obligacione i mbulojnë të gjitha deficitet e arkave shtetërore të Gojëve.

Ndalesa e burzave valutore

Kur ne të arrijmë në fronin gjithpërfshirës, të gjitha këto barna mjekues do të zhduken, sepse do të jenë në kundërshtim me interesat tona. Ne do t'i ndalojmë gjithashtu edhe të gjitha burzat valutore, sepse nuk do të lejojmë që të lëkundet prestigji i pushtetit tonë me ndërrimin e çmimeve të valutave tona. Ato do të jenë të stabilizuara me ligjet tona dhe nuk do të mund të ndryshohen. Ngritja tërheq me vete uljen. Ne do të fillojmë t'i ngrisim valutat e Gojëve, por nuk do të luhatemi të kalojmë edhe në ulje.

Shënimi i çmimit të valutave tregëtare

Bursat do t'i zëvendësojmë me ente të mëdha zyrtare fetare, të cilët do të do të kenë rol që, sipas udhëzimeve të qeverisë, të vejnë tatimin mbi vlerat industriale. Këto ente do të munden, që brenda një dite, t'i hedhin në treg vlerat industriale në lartësinë gjer 500 milion ose aq edhe t'i blejnë. Në këtë mënyrë këto ndërmarrje industriale do të varen nga qeveria e jonë. Mund të paramendoni se çfarë pushteti do të arrijmë me këtë mënyrë.

SEANCA E NJËZET E GJASHTË

Monopoli i ynë shkatërron begatinë e Gojëve

Së shpejti do t'i organizojmë monopo-let e rëndësishme, rezervoaret e pasurisë së fuqishme, nga të cilat do të varen edhe begatitë më të mëdha Goje, ashtu që ato do të zhduken në të njejtën kohë me zhdukjen e kreditit shtetëror, ditën e nesërme, pas fundosjes së tyre politike. Të gjithë ju, zotërinj të pranishëm, ekonomistë, urdhëroni dhe peshoni rëndësinë e një kombinimi të këtyllë... Përparësia e Mbiqeverisjes sonë do të rritet shkallë-shkallë; ajo do të konsiderohet mburojë, zbatuese dhe dhuruese e liberalizmit.

Zbatimi i taksave - zhdukje e begatisë tokësore të aristokracisë Goje

Nëse aristokracia është fuqi legale, do të jetë e vdekur; nuk do të mirremi më me të. Nëse ajo është pronare e të mirave të patundshme, na dëmton, sepse mjetet financiare të saj ia sigurojnë pavarësinë dhe mundësinë për të mbajtur në duar të veta pronën e patundshme. Ne duhet të bëjmë gjithçka që kjo pasuri e patundshme të kalojnë në duar të popullit, të cilin ne kemi filluar ta mësojmë me punë bujqësore, e për të cilat nuk ka aftësi të mjaftueshme, meqenëse është orientuar në tregëti dhe komisione, gjegjësisht në spekulacione. Të gjitha punët tona kanë për qëllim t'i shkatërrojnë Gojët për të qenë robërit tanë, në kohën kur duke zbatuar kreditin në patundshmëri, të gjitha pronat e pasanikëve dhe të fshatarëve, do të kalojnë në duart tona. Atëherë, për t'u ushqyer, Gojët do të jenë të detyruar të punojnë për ne, sepse askush nuk do t'ju shesë më prodhimet bujqësore, siç ka qenë në kohë të Sallamonit. Ne do t'i ushqejmë dhe ruajmë për punë, si kafshë dhe si limona për shtrydhje. Kur ne të qeverisim, e drejta normale e njeriut për të shitblerje do të ndalohet. Për të arritur tek kjo, mjete më i mirë është leçitja e aristokracisë nga prona e tij; kjo pastaj mund të bëhet edhe me fshatarët. Metoda më e suksesshme për zbatimin e këtij plani është ngritja e taksës dhe e tatimit mbi patundshmërinë; me fjalë të tjera, futja e tokës në borxh. Kjo varësi do t'i mbajë Gojët, pronarët e pasurisë së patundshme, në gjendje robërimi të perezistueshëm. Aristo-kratët e tyre, duke mos ditur t'i ndihmojnë vegjëlisë, së shpejti do të shkatërrohen dhe lëshojnë tokat e tyre, të cilat do t'i blejmë ne si dhurata, nëse jo personalisht - së paku për një çast - atëherë nëpërmes njerëzve të thyeshëm.

Spekullimet

Në të njejtën kohë duhet aktivisht të mbrojmë tregëtinë dhe industrinë, para së gjithash spekulacionin, i cili do të shërbejë si kundërpeshë e industrisë. Pa spekulacione industria do të mblidhte kapital privat, dhe kjo do të mund të përmirësojë gjendjen e bujqëve, duke liruar tokat në të cilat janë evidentuar borxhet e kreditit të entit mbi tokën. Përkundrazi, do të na nevojitet që industria ta shuajë pasurinë bujqësore dhe përmes shpekullimeve të bëjë që e tërë pasuria e botës të kalojë në duart tona, duke i hudhur Gojët në rradhët e proletariatit. Atëherë ata do të përulen para nesh, vetëm për të fituar të drejtën e ekzistencës.

Jeta luksoze

Për të shkatërruar industrinë e Gojëve, me ndihmën e punëve spekulative, do të fusim në jetën e tyre luksin e shfrenuar, me të cilin gjithçka shkatërrohet.

Rritja e rrogave dhe shtrenjtimi i jetës

Rrogat do t'i rrisim, por kjo nuk do t'ju ndihmojë aspak punëtorëve, sepse në të njejtën kohë do t'i ngrisim çmimet e artikujve jetësorë, me arësyetim se ka rënë bujqësia dhe kujdesi për punët bujqësore.

Futja e shprehisë së alkoholit tek punëtorët

Aq më shumë, ne do t'i mbyllim me kujdes të gjitha burimet e prodhim-tarisë, duke i nxitur punëtorët të përdorin alkoholin. Sa i përket Gojëve intelegjentë, ata do t'i zhdukim nga faqja e dheut.

Mashtrimi i punëtorëve me shkencat tona ekonomike

Me qëllim që Gojë të mos i shohin nga lartë letrat tona të lojës, do t'i fshehim ato, gjoja me dëshirën se i shërbejmë klasës punëtore dhe parimeve të larta ekonomike, të shprehura me teoritë tona ekono-mike.

SEANCA E NJËZET E SHTATË

Simboli i Gjarpërit dhe domethënia e tij

Sot mund t'ju dëshmoj se jemi vetëm disa hapa të larguar nga qëllimi. Ja plani i gjithë rrugës të cilën e kemi kaluar dhe distanca e vogël të cilën duhet kaluar akoma, në mënyrë që të plotësohet rrethi Simbolik i Gjarpërit, simbolit të popullit tonë. Kur ky rreth të mbyllet përfundimisht, të gjitha shtetet e Europës do të gjenden në kthetrat tona të forta.

Paqëndrueshmëria e kushtetutave kryengritëse - frika nga terrori para kështjellave Goje

Së shpejti do të trazohet peshorja e kushtetutave moderne, sepse meka-nizmin e saj e kemi shkatërruar që në kohën e themelimit të tyre, kështuqë enët e saj, duke anuar herë në njërin e herë në anën tjetër, më në fund do ta shkatërrojnë llozin në të cilin mbahet peshorja. Gojë të kanë imagjinuar se e kanë ndërtuar në mënyrë solide, gjithmonë duke shpresuar se ajo më në fund do ta gjejë drejtpeshimin. Por, sovranët, para syve të popullit janë të ngjeshur me përfaqësues të popullit, të cilët bëjnë marrëzira, sepse janë të papërgjegjshëm dhe pa kontroll. Ata janë të vetëdijshëm se pushtetin e tyre ia kanë borxh vetëm terrorit i cili sundon në kështjellë. Sovranët e tyre, duke iu frikuar popullit, nuk mund të shkojnë në mesin e tij, për t'u marrë vesh, si dikur, dhe për t'u mbështetur tek ai kundër uzurpatorëve të pushtetit. Pushteti transparent i sovranit dhe pushteti i verbër i popullit, njëherë të ndarë nga ne, e kanë humbur tërë rëndësinë e tyre, dhe kështu të vetmuar, janë bërë të pafuqishëm si edhe i verbëri pa shkop.

Luftrat partiake - Ambicjet e tyre

Për t'i shtyer karrieristët e etshëm të tyre për keqpërdorim të pushtetit, i kemi ngritur këta dy faktorë kundër njëri tjetrit, duke ju zhvilluar tendencat e tyre liberale për pavarësi. Në këtë kuptim ne i kemi nxitur të gjitha iniciativat e mundshme, duke ju lënë edhe armë në duar partiake, ndërsa pushtetin e kemi bërë shenjë të ambicjeve të tyre. Me anë të alarmeve shtetet e tyre i kemi shndërruar në arena.

Fjalimet parlamentare dhe gazetarët arrogantë

Ka mbetur edhe pak, kur turbullirat dhe bankrotet do të trondisin institucionet ekzistuese.

Llomotitësit e pashterrshëm, mble-dhjet parlamentare dhe kuvendet e tjera drejtuese, i kanë shndërruar në vatra fjalamanie konfrontimi. Gazeta-rët arrogantë e të pafytyrë dhe përpiluesit e pavëmendshëm të pamfleteve, sulmojnë

për çdo ditë personelin e tyre udhëheqës. Keq-përdorimi i pushtetit do të sjellë përfundimisht shkatërrimin e institucioneve dhe gjithçka do të shkojë në ajër nga goditjet e masës së çoroditur nga liberalizmi.

Fiksioni i të drejtës për kryengritje

Ne i kemi robëruar aq shumë popujt nëpërmes mjerimit, në të cilën nuk kanë qenë as në kohën kur më në fund i kemi liruar nga armiqt e tyre; por ata tani nuk do t'i lirohen mjerimit. Të drejtat të cilat i kemi vendosur në kushtetuta për masat, janë vetëm fiktive por kurrsesi reale. Këto të drejta janë shprehje e idesë së parealizueshme.

Opozita e pushtetit dhe e popullit

Çka i ka mbetur më punëtorit të kërrusur nga pesha e rëndë e punës, apo proleterit të shtypur nga fati i tij, kur llafazanët e kanë fituar të drejtën që për çështje serioze vetëm të flasin, ndërsa gazetarët vetëm të shkruajnë mbi lloj - lloj marrëzish. Popullit nuk i ka mbetur gjë tjetër, përpos t'i blejë trohat e bukës nga tryeza jonë, të cilat ua hudhim ne, për t'i votuar ligjet tona e për t'i zgjedhur agentët tanë. Të drejtat republikane për punëtorët janë vetëm një ironi e hidhur, sepse, për të nxjerrë ndonjë interes nga këto të drejta, i pengon nevoja e punës së përditshme, derisa të mos ju shkëputen edhe garancionet mbi sigurinë dhe marrjen e përhershme të rrogës, duke i obliguar që ne (varësisht nga grevat të cilat i organizojnë patronët e tyre - të cilat i nxisim kur na duhet për të kthyer vëmendjen nga punët tona), t'ju imponojmë ndonjë masë e cila na shkon për shtati.

Të pasurit dhe të sapaardhurit

Popujt dhe qeveritë, nën dirigjimin tonë, e kanë çrrënjësuar aristokracinë e tyre, e cila ka qenë mbështetëse e tyre, një mbrojtje (për interesa të saja) duke i plotësuar edhe nevojat e tyre. Kështu, ata sot kanë rënë nën pamëshirën e uzurpatorëve të pasuruar rishtas, të cilët i kanë zënë pozitrat e larta, dhe si një barrë e padurueshme ushtrojnë presione mbi punëtorët.

Kriza ekonomike botërore

Kjo armiqësi do të theksohet gjithnjë e më shumë kur do të shfaqet kriza ekonomike, e cila do të bllokojë marrëveshjet financiare dhe tërë jetën industriale. Këto ngjarje do të hedhin një numër të pafund të punëtorëve në rrugët e të gjitha shteteve të Europës. Kujtohuni se me sa vullnet do të sulen të derdhen gjakun e atyre, të cilët i kanë urreyer që nga fëmirija.

Tanët do të jenë të mbrojtur

Ata nuk do të drejtohen kundër tanëve, sepse ne, duke e ditur çastin e sulmit të tyre, do t'i marrim të gjitha masat për t'u mbrojtur, ashtu siç kemi vepruar në kohë të komunës së Parisit.

Pushteti ynë do të mbysë liberalizmin

Gojëve ju kemi dëshmuar se përparimi do t'i sjellë gjer në vetëdijen mbretërore. Despotizmi i ynë do të jetë i atillë, që ai do t'i qetësojë të gjitha kryengritjet me masa të mençura dhe rigoroze. Ai do ta eliminojë liberalizmin nga të gjitha institucionet tona.

Rënja e pushtetit dhe revolucioni i madh

Prandaj, duke ju imponuar Gojëve idetë e liberalizmit, popujt e kanë ndjerë se, në emër të lirisë, pushteti vetëm ka bërë koncesione dhe lëshime. Nga kjo kanë konkluduar (kanë jetuar me iluzione!) se paraqesin një forcë me të cilën duhet të llogaritet, dhe duke menduar se të drejtat e tyre janë të njejta me të drejtat e qeverisë, janë ngritur në kryengritje. Por, të ngjashëm me të verbërit e tjerë, kanë hasur në pengesa të panumërta. Vrapuan të gjenin një udhëheqës: por ranë në duart tona duke e lëshuar mandatin e tyre para këmbëve të agjentëve tanë!

Fuqia ndërkombëtare e masonerisë

Sot, si fuqi ndërkombëtare që jemi, jemi të palëndueshëm. Nëse ndonjë shtet gojim na sulmon, tjetra na ndihmon. Përrultësia e popujve gojimë është aq e pafundshme, sa që ata vetëm zvarriten para fuqisë sonë. Gojëjt janë të pamëshirshëm vetëm para dobësive dhe gabimeve edhe më të vogla, ndërsa tolerues ndaj krimeve; nuk i nënshtrohen pushtetit të drejtë, por janë të durueshëm deri në torturë, para ashpërsisë së despotizmit të vendosur. Kjo është ajo që siguron të jemi të pa-lëndueshëm.

Gojëjt nga kryeministri i tyre, -diktatorët tanishëm të cilët i kemi dresuar- durojnë keqpërdorimet për të cilat ua kishin prerë kokat njëzet mbretërve...

Edukimi i gabuar i popujve

Kjo ndodh sepse agjentët tanë i bindin ata, pushtetarët gojimë, se dëmet që ata i sjellin shtetit, sjellin lumturinë ndërkombëtare, vëllazërinë e popujve, solidaritetin (kuptohet se nuk ju flitet se këtë bashkësi të popujve do ta realizojë vetëm pushteti ynë, nën pushtetin tonë ndër-komëtar). Dhe ja, populli i akuzon të pafajshmit, dhe i liron fajtorët, vetëm për të dëshmuar se është zot i situatës. Duke garuar kështu me përfaqësuesit e tyre në pushtet, populli rrënon çdo baraz-peshë dhe gjithkund krijon trazira.

Liria

Fjala "liri" e ven në konflikt njerëzimin me të gjitha forcat, pra edhe me forcat e Zotit dhe të natyrës. Prandaj jemi të detyruar që, kur të vijmë në pushtet, të fshijmë nga fjalori edhe vet emrin "liri", si simbol të fuqisë shtazarake, e cila masat i shndërron në egërsira të etshme për gjak. Mirëpo, gjithashtu është e vërtetë se, egërsirat e ngopura me gjak i zë lehtë gjumi, të cilat është lehtë t'i lidhësh. Përndryshe, nëse ju mungon gjaku, nuk flejnë por rrihen njëri me tjetrin.

Përktheu: Fatos Aliu

Redaktor: Vanqjush Gambeta

- *Lidhjet ilustruese janë të pashtriku.org*